



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9/186/2018
Data: 05.11.2018

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e tetë -VIII- për vitin 2018 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 18.09.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Bashkim Sopa (Zyrtar për transparencë), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Përfaqësuesi i OSB-së. Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-shtator 2018.
3. Shqyrtimi i rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019.
4. Informatë mbi suksesin e arritur për përfundimin e vitit shkollorë 2017/2018.
5. Informatë mbi raportin nëntë mujor të N.P.L "Pastrimi".

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri. (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-shtator 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- janë paraqitur të gjitha detalet në raportë. Është paraqitur performanca e shpenzimeve dhe të hyrave. Të hyrat vetanake kanë shënuar trende rritëse rreth 18.84 % që korrespondon me 36 000 € me nëntë mujorin e vitit paraprakë. Kjo rritje ka ardhur nga të hyrat e tatimit në pronë dhe nga dënimet në trafik. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për periudhën janar-shtator 2018 është në shumë prej 1,503,347.24 € apo 50.14 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,082,113.36 € apo 74.93 %, për mallra dhe shërbime 132,215.33 € apo 57.57 %, për shpenzime

komunale 31,104.27 € apo 69.85 %, për subvencione dhe transfere 36,485.80 € apo 69.11 % dhe për shpenzime kapitale 221,428.48 € apo 18.04%. Të hyrat vetanake për periudhën nëntëmujore 2018 janë realizuar në shumë prej 226,194.68 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Akif Shkreta thekson:- kërkoj sqarim te tabela numër katër se është shënuar pagesa për sindikatë në shumë prej 3167.00 €. Tabela numër pesë kodit shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit (transporti i nxënësve) dhe mendoj që duhet të jetë kod i veçantë transporti i nxënësve.

Kryesuesi thekson:- shpenzimet kapitale janë në shumë prej 18 % dhe si është në krahasim me vitin e kaluar.

Mehmet Ballazhi thekson:- kërkoj sqarim për ngritjen që është bërë te pagesa për kategorinë paga dhe mëditje 5.49 %, te mallrat dhe shërbimet 0.58 %. Cilët janë faktorët që kanë ndikuar për me u rritë të hyrat apo janë bartje të mjeteve financiare nga viti i kaluar .

Samire Curri thekson:- drejtori dha disa sqarime për të hyrat buxhetore dhe për shpenzimet. Shpenzimet janë realizuar mirë por nga ky raport shihet se është bërë një realizim i mirë i të hyrave vetanake.

Shabi Rexhallari thekson:- pagesa për sindikatë ka të bëjë me sindikatën e arsimit dhe të shëndetësisë. Shpenzimet e udhëtimit zyrtarë brenda vendit kemi shënuar në kllapa transporti i nxënësve në mënyrë që me u ditur që është bërë shpenzimi për atë qëllim e jo për qëllim tjetër. Po të kish pas kodë adekuatë e kishim vendosë te transporti i nxënësve. Te shpenzimet kapitale është një përqindje jo aq e mirë që kemi 18% , kurse vitin e kaluar kemi pas 21.6% . Nëse shikohen në shifra në këtë vit i bien që kemi shpenzuar më shumë. Arsyeja se pse është kjo shumë është për shkak se janë duke u kryer punë e projekteve në teren për shkak se pa u kryer projekti nuk mund të kryhet pagesa. Për pagat dhe mëditje është një rritje prej 5.49 % sepse të ngritjes së pagave nga niveli qendrorë që është bërë 4 % nga muaji janar. Rritja prej 0.58 % është enorme për shkak të ndriçimit publik që është shtuar vitin e kaluar dhe nuk është që ka ndikuar shumë në total. Te tatimi në pronë kemi filluar me shpërndarë vërejtje për ata të cilat kanë obligime ndaj komunës sepse kemi pas në raport të auditimit. Kjo rritje e të hyrave kryesisht është nga borxhet që i kanë qytetarët në tatim pronë.

Nora Xhoni thekson:- për ndriçim publik granti qeveritarë jep 15000 € kurse 10000 € janë nga të hyrat vetanake dhe në total janë 25000 € por të shpenzuara janë vetëm 21000 €.

Shabi Rexhallari thekson:- planifikimet janë bërë për 25000 € kurse oferta është 21000 €, kurse pjesa tjetër është rialokuar në projektet e tjera.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIU DHËN JANAR – SHTATORË QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- nga data një tetor është në fuqi ligji i ri dhe parashihet me hyjë në taksë edhe tatimi në tokat bujqësore, mirëpo pa u dërguar një raport nga Ministria e Financave nuk mund ta dimë se sa do të jetë vlera e tatimit në tokë. Afati ligjorë sipas këtij ligji është deri më 31 tetor që me na i dërguar raportin në mënyrë që komuna me ditë vlerën e tatimit në tokë. Rregullorja është ashtu siç ka qenë vitet e kaluar por ndryshim kemi te neni gjashtë që përcaktohet kategoria e pronës. Vitin e ardhshëm do të kemi një zbritje që për çdo 100 m² do të kemi 7.50 € për çdo faturë. Afatet e pagesës deri më tani ishte kësti parë deri më 31 qershor dhe kësti i dytë 31 dhjetorë , kurse në bazë të këtij ligji do të jetë 30 prilli kësti i parë dhe kësti i dytë do të jetë me 30 shtatorë. Nga viti tjetër kemi drejtë me përmbarues privat me iniciuar procedura.

Nora Xhoni thekson:- tatim paguesit të cilët janë jashtë vendit për shkak se ka persona të cilët posedojnë pronë dhe shtëpi por nuk kthehen për një kohë të gjatë. Çfarë metode të ftesës do të përdorni për me paguar tatimin në pronë në mënyrë që mos me i dërguar në përmbarues privat.

Akif Shkreta thekson:- neni i 4.2 të gjitha parcelat të cilat gjenden pranë rrugës magjistrale Prishtinë – Shkup në tërë territorin e komunës dhe të cilat kanë qasje të drejtpërdrejt, po ashtu përfshihen në zonën e I-rë, t'i shtohet se kanë qasje të drejtë për drejtë në magjistrale. Neni 5.3 është mirë që fjala izvor të zëvendësohet me fjalën burim.

Kryesuesi thekson:- ankesa ka pas që afati i parë mos me pas kamatë , kurse me ligj të ri afati është ngushtuar dhe është në muajin prill dhe shtatorë. A parashihet kamatë për afatin e parë sepse çdo herë kemi pas ankesa nga qytetarët që afati i parë me qenë lehtësues e mos me ngarkuar palën me kamatë. Në Ministri të Pushtetit Lokal kemi dhënë vërejtje që për afatin e parë me pas lehtësime dhe mos me pas kamatë.

Shabi Rexhallari thekson:- deri me datë tridhjetë prill ata të cilët paguajnë nuk do të ndëshkohen me kamatë kurse nga data një maj ndëshkohen me kamatë. Për tatim paguesit për personat të cilët janë jashtë vendit fillimisht ua dërgojmë familjarëve të tyre dhe nëse nuk mundemi në këtë formë mundohemi në formë elektronike përmes rrjeteve sociale me njoftuar.

Mehmet Ballazhi thekson:- në lagjen tonë ka pas zëra nga qytetarët të cilët kërkojnë që me kaluar nga zona e parë në zonë të dytë por në debat publikë kur të diskutohet munden me dhënë propozime.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA RREGULLORJA PËR TATIM MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

4. Informatë mbi suksesin e arritur për përfundimin e vitit shkollorë 2017/2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- materialin e keni pranuar me kohë. Raporti për vitin shkollorë 2017/2018 është raport numerikë. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Akif Shkreta thekson:- në këtë informatë për çdo fundvit duhet testi për shkallë kurikurale edhe në shkollat fillore edhe në shkollat e mesme.

Mehmet Ballazhi thekson:- përveç suksesit do të ishte mirë që të përfshihen edhe problemet tjera brenda shkollave.

Akif Shkreta thekson:- komuna ka investuar për ujin e pijes dhe ka qenë një projekt që ka filluar mirë dhe ishte funksional afër katër muaj. Nxënësit e kanë përdorur atë ujë sepse në bazë të analizave që janë bërë ka qenë uji i pijes, mirëpo tash është jashtë funksionit. Janë bërë investime mbi shtatë mijë euro për aparatën e filtrimit dhe është jashtë funksionit. Në mbledhjet prindërore ishte shqetësim i prindërve kjo çështje dhe është mirë me rifunksionalizuar.

Samire Curri thekson:- pasi sezona e dimrit po afrohet a janë furnizuar shkollat me lëndë djegëse.

Mallzum Qajani thekson:- është në proces furnizimi me dru dhe në afat optimal kryhen, mirëpo të gjitha shkollat kanë mundësi me filluar me sezonin e nxehjes në afat optimal.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATA MBI SUKSESIN E ARRITUR PËR PËRFUNDIMIN E VITIT SHKOLLORË 2017/2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë mbi raportin nëntë mujor të N.P.L “Pastrimi”.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.


Mallzum Qajani thekson:- me që bordi i aksionarëve është në ristrukturim e sipër dhe njëri që do të vjen kryesues i bordit është jashtë vendit për shkak të vizitës zyrtare, propozoj që të përcillet për kuvend kjo pikë e rendit të punës.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATA MBI RAPORTIN NËNTË MUJORË TË N.P.L PASTRIMI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

Mbledhja përfundoi në ora 12:40 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

